

GJYKATA THEMELORE NE PRISHTINË-Departamenti për Çështje Ekonomike, me gjyqtaren Franciska Zhitia-Ymeri, në çështjen juridike të paditësit Kompania e Sigurimeve A.S, H. , Z, të cilën e përfaqëson sipas autorizimit I.A, L.L.C, avokat B.N nga Prishtina, kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve “ S” me seli në P, të cilën e përfaqësojë sipas autorizimit A.P jurist nga P , me objekt kontesti shpërblim dëmi në shumën e përgjithshme prej 23,868.10 euro, pas përfundimit të seancës kryesore publike të datës: 28.09.2016, ndërsa pas marrjes së fjalës përfundimtare nga palët në procedurë, me datë: 13.10.2016, mori këtë:

A K T G J Y K I M

APROVOHET në tërësi si e bazuar kërkesëpadia e paditësit Kompania e Sigurimeve A.S, H., Z.

I. Detyrohet e paditura Kompania e Sigurimeve “ S” me seli në P, që paditësit t’ia paguaj në emër të shpërblimit të dëmit, shumën e përgjithshme prej 21,515.71 euro (njëzetë e një mijë e pesëqind e pesëmbëdhjetë euro e shtatëdhjetë e një cent), me kamatë ligjore prej 12%, duke llogaritur nga data 22.04.2015, e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afatin parativ prej 7 (shtatë) ditëve, duke llogaritur nga data e pranimit të këtij aktgjykimi nën kërcënimin e përmbarimit me detyrim.

II. Detyrohet e paditura që paditësit t’ia kompensoj edhe shpenzimet e procedurës kontestimore në shumën e përgjithshme prej: 1,490.70 euro, në afatin kohor prej 7 ditëve nën kërcënimin e përmbarimit me detyrim.

A r s y e t i m

Paditësi Kompania e Sigurimeve A.S, H., Z, ka paraqitur padi pranë kësaj Gjykate për shpërblimin e dëmit- kasko regres të pësuar nga aksidenti i komunikacionit me datë 20.07.2014, për çka edhe ka kërkuar nga gjykata t’ia paguaj shumën e përgjithshme prej 23,868.10 euro, me kamatë ligjore prej 12 % duke filluar nga data 22.04.2015, e deri në pagesën definitive si dhe shpenzimet e procedurës kontestimore kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve “ S” me seli në P.

I autorizuari i paditësit gjatë gjithë shqyrtimit gjyqësor dhe pas marrjes së mendimit dhe konstatimit të ekspertit të komunikacionit dhe makinerisë S.B të datës 22.05.2016 si dhe pas sqarimeve shtesë nga i njëjti ekspert në seancën e datës 28.09.2016, ka bërë precizimin e kërkesëpadiës në shumë prej 21,515.71 euro, me kamatë vonesë prej 12 % duke filluar nga data 22.04.2015 e deri në pagesën definitive, duke shtuar se me datën 02.08.2014 në Fushë Kosovë ka ndodhur aksident trafiku ku ishin përfshirë A.S në cilësi të vozitësit të automjetit Opel ascona me targa... dhe i siguruari i paditësit V.M në cilësi të vozitësit të automjetit BMW, me targa..., kështu që deri te shkaktimi i aksidentit ka ardhur me përdorimin e automjetit të markës Opel Ascona pronë e H.S dhe i drejtuar nga A.S, kështu që vozitësi nga pakujdesia tenton të kyçet në rrugën kryesore nga rruga dytësore dhe me këtë rast godet automjetin e tipit BMW, me targa... i siguruar kasko te paditësi, po ashtu automjeti Opel Ascona me targa ..., me përdorimin e të cilit është shkaktuar aksidenti në momentin e aksidentit ishte i pajisur me polic të vlefshme sigurimi sipas policës TPL, nr. ... dhe ka kërkuar nga gjykata që kërkesëpadinë e saj ta aprovoi në tërësi si të bazuar.

Shpenzimet e procedurë i ka kërkuar dhe i ka specifikuar.

I autorizuari i të paditurës përmes përgjigjes në padi ka kundërshtuar në tërësi bazën juridike dhe lartësinë e kërkesëpadisë, duke shtuar se lartësia e dëmit duhet të merret sipas çmimit të tregut e jo sipas faturës të serviseve të shteteve të huaj meqenëse aksidenti ka ndodhur në Kosovë, andaj dhe ka propozuar gjykatës që kërkesëpadinë e paditësit ta refuzoj si të pabazuar.

Shpenzimet e procedurës kontestimore nuk i ka kërkuar.

Për zgjidhjen e kësaj çështje juridike Gjykata i administroi provat e propozuara nga palët në procedurë dhe atë duke filluar nga: policia e sigurimit auto-kasko nr..., konstatimi i dëmit sipas ekspertit Graf i datës 06.08.2014, me numër 249931, me foto dokumentacion dhe leje qarkullimi, fatura për riparimin e automjetit me nr. 4954/5758 e datës 16.10.2014, fatura me nr. 1/2014, e datës 20.07.2014, me nr. 12014 e datës 20.07.2014, raporti i policisë me fletëparaqitje për kundërvajtje e datës 20.07.2014, si dhe kërkesat në procedurë të rregullt të datës 22.04.2015, me korrespondencë mes palëve ndërgjyqëse, ekspertiza e komunikacionit e datës 22.05.2016 dhe ekspertiza e makinerisë e datës 23.05.2016, të dyja të punuara nga eksperti gjyqësor S.B.

Provat e propozuara dhe të administruara, deklaratimet e të autorizuarve të palëve ndërgjyqëse dhe ekspertizat gjyqësore, gjykata i vlerësoi, të gjitha një nga një dhe në varësi me njërën tjetrën, në vështrim të nenit 8 të LPK-së .

Për përcaktimin e përgjegjësisë dhe vlerësimin e lartësisë së dëmit gjykata me propozimin e palës paditëse ka nxjerrë provën me anë të ekspertizave të komunikacionit dhe të makinerisë nga eksperti S.B. Ku sipas mendimit dhe konstatimit të këtij eksperti të dhënë në ekspertizën e komunikacionit të datës 22.05.2016, eksperti ka theksuar se ngasësi i automjetit "A" të tipi Opel duke bërë lëvizje të rrezikshme, duke u futur në udhëkryq pa u kujdesur për sigurinë në komunikacion, duke mos respektuar rregullat e përparësisë së kalimit e ka penguar/goditur ngasësin e automjetit "B" BMW dhe në këtë mënyrë është shkaktuar aksidenti. Eksperti ka konstatuar se ngasësi i automjetit "A" të tipit Opel është shkaktar i aksidentit kurse ngasësi i automjetit "B" të tipit BMW-5, nuk ka kontribuar në aksident.

Kurse sipas mendimit dhe konstatimit të ekspertizës së makinerisë të datës 23.05.2016 nga eksperti S.B dhe sipas sqarimeve shtesë në seancën e datës 28.09.2016 ka vërtetuar faktin se deri te automjeti i udhëtareve BMW, ka pasur dëmtime të mëdha materiale në pjesën anësore majtas, në automjetin e sipër përmendur janë dëmtuar disa pjesë. Eksperti ka theksuar se pasi që automjeti është riparuar në Zvicër vlera e dëmit duhet të merret nga vlerësimi i siguresit Kasko, vlera e përgjithshme së bashku me TVSH arrin shumën prej 23,432.76 CHF.

Gjykata i besoi plotësisht konstatimit të ekspertit pasi që i njëjti përcaktimin e lartësisë së dëmit e kishte bërë duke marrë për bazë shkresat të cilat gjinden në lëndë, dhe në bazë të këtij dokumentacioni për vlerësimin e çmimeve të pjesëve të riparimit dhe orëve të punës ka aplikuar çmimet e tregut në Zvicër i cili është mesatarisht rreth 152.00 CHF dhe në

formë tabelare ka paraqitur në ekspertizë pjesët që janë ndërruar dhe ato që janë riparuar, orët e punës për riparimin e automjetit dhe çmimet për njësi.

Paditësi ka bërë kompensimin e dëmit në shumën prej 23,432.76 CHF , gjykata në bazë të kursit valutor të BQK-së, të datës 28.09.2016, ka konstatuar se në të njëjten datë 1 CHF, ka qenë e barasvlefshme me 1,089.10 euro. Kjo do të thotë që shuma e paguar 23,432.76 CHF, është e barasvlerëshme me 21,515.71 euro, andaj edhe u vendos si në diapozitiv të këtij aktgjykimi.

Meqenëse nga provat e administruara u vërtetua se paditësja ia ka kompensuar të siguarit të saj kompensimin e dëmit ndërsa po ashtu u vërtetua se i siguruari i të paditurës ishte shkaktar i dëmit, gjykata duke u bazuar në dispozitën enenit 154 paragrafi 1 të LMD-së, dhe mbi gjendjen faktike të vërtetuar, ka gjetur se kërkesëpadia e paditësit është e drejtë dhe e bazuar andaj të njëjtën e ka aprovuar dhe ka vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit.

Në kontekstin e përgjithshëm të procedurës provuese, duke vlerësuar pretendimet e paditësit, respektivisht të autorizuarit të tij dhe kundërshtimet e të autorizuarit të paditurës, gjykata ju referua nenit 939 par. 1, të LMD-së, sipas të cilit “me pagimin e kompensimit nga sigurimi kalojnë (subrogohen) në siguruesin të gjitha të drejtat e të siguarit ndaj personit përgjegjës për kompensimin e dëmit”. Meqenëse nga provat e administruara u vërtetua se paditësja ia ka kompensuar të siguarit të saj kompensimin e dëmit ndërsa poashtu u vërtetua se i siguruari i të paditurës ishte shkaktar i dëmit, gjykata duke u bazuar në dispozitën e sipërcituar dhe mbi gjendjen faktike të vërtetuar, ka gjetur se kërkesëpadia e paditësit është e drejtë dhe e bazuar andaj të njëjtën e ka aprovuar dhe ka vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit.

Gjykata vlerësoi edhe pretendimet e të paditurës se ekspertiza e makinerisë nuk i ka llogaritur çmimet sipas tregut në Kosovë por sipas vlerave të tregut të shtetit Zvicëran, por gjykata ka gjet se në bazë të nenit 8 paragrafi 2 pika g të BQK thuhet “se dëmi në mjetin motorik të dëmtuar me targa të huaja mund të pranohet në bazë të faturës së riparimit të bërë në vendin e regjistrimit të mjetit motorik duke bërë krahasimin e atij riparimi me procesverbalin mbi dëmin” andaj mbi këtë bazë gjykata e ka hudhë poshtë pretendimin e të paditurës.

Gjykata refuzoj me aktvendim propozimin e palës së paditur për caktimin e ekspertizës së re duke konsideruar këtë propozim të paarsyeshëm dhe të pa specifikuar se për cilat çështje do të sigurohet një ekspert tjetër, ku palët në procedurë kanë dilema dhe kanë marr në pyetje ekspertin e makinerisë me rastin e shqyrtimit të kësaj çështje civile-juridike dhe eksperti është përgjegjës për të gjitha pretendimet e palëve në procedurë, kështu gjykata nuk ka pas asnjë arsye që të angazhoj një ekspert tjetër. Për kundër faktit se asnjëra palë nuk e ka kontestuar objektivitetin, dhe profesionalizmin e ekspertit lidhur me këtë ekspertizë.

Meqenëse e paditura lidhur me pagesën e detyrimit që rrjedh nga kasko sigurimi ka rënë në vonesë, gjykata e detyroj të paditurën që në shumën e gjykuar, në vështrim të dispozitës së nenit 26 paragrafi 6 të Ligjit për Sigurimin e Detyrueshëm nga Autopërgjegjësia, paditësit

t'ia paguajë kumatën vjetore në lartësi prej 12%, ashtu si është cekur në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës kontestimore është marrë në bazë të nenit 452. paragrafi 1 të LPK-së, në rastin konkret shpenzimet e krijuara gjyqësore si detyrim i të paditurit, i referohen shumës së precizuar si në pikën II të dispozitivit të aktgjykimit, e cila përfshin shpenzimet procedurale të kërkuara dhe të provuara nga paditësi, dhe atë: për përpilimin e padisë shumë prej 208.00 euro €, për aktgjykim shumë prej 169.35 euro, në emër përfaqësimit në seanca (2x270.40 euro) në shumë prej 540.00 euro, për ekspertizë shumë prej 300.00 €, për taksën për padi 169.35 €, për parashtrësë shumë prej 104,00€, në shumë të përgjithshme prej 1,490.70 €, ndërsa pjesën tjetër të shpenzimeve të kërkuara nga paditësi gjykata nuk i mori për bazë pasi që nuk janë të specifikuar.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
–Departamenti Për Çështje Ekonomike–
III.C.nr. 213/2015 me datën 13.10.2016

Gjyqtarja
Franciska Zhitia Ymeri

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afatin kohor prej 7 (shtatë) ditëve, llogaritur nga dita e pranimin të të njëjtit, duke iu drejtuar Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.